

**DRITAN EGRO**

**DISA TË DHËNA TË REJA MBI FILLIMET  
E NACIONALIZMIT SHQIPTAR**

Studimi i nacionalizmit shqiptar është një nga problemet më komplekse të historisë moderne shqiptare. Fati historik i shqiptarëve në shek. XIX-XX dhe ideologjizimi i skajshëm i këtij problemi në Shqipërinë komuniste, në vështrim të parë, duket se janë dy faktorët kryesorë që nuk kanë lejuar deri më sot të kryhen trajtime akademike shteruese për këtë problem, por po kaq kanë lënë ende të pazbuluara edhe rrënjët e tij.

Ky shkrim synon të parashtrojë disa të dhëna të reja mbi fillimet e mendimit nationalist shqiptar, të cilat aq sa mund të hedhin një dritë të re mbi kohën dhe fillimet e fenomenit të nacionalizmit shqiptar, po aq edhe mund të shërbejnë si indikator për t'i thelluar më tej kërkimet arkivore për këtë fenomen.

Studimet shkencore në Shqipëri mbi nacionalizmin shqiptar apo Lëvizjen Kombëtare Shqiptare siç është quajtur ideologjikisht gjatë periudhës komuniste, kanë filluar qysh në vitin 1953,<sup>1</sup> dhe vazhduan më intensivisht në vitin 1965. Pyetjes se ku i ka rrënjët në kohë nacionalizmi shqiptar dhe cili ka qenë shtrati që e përgatiti atë, historiografia e periudhës komuniste nuk arriti t'i japë një përgjigje shteruese. Ndonëse pati studiues, si Stefanaq Pollo,<sup>2</sup> Stavri Naçi,<sup>3</sup> Injac Zamputi<sup>4</sup> dhe K.

---

<sup>1</sup> Stefanaq Pollo, "Mbi formimin e kombit shqiptar dhe lëvizjen nacionale shqiptare", *Buletin për shkencat shoqërore*, II (1953), f. 32-49; Kristo Frashëri, "Mbi formimin e kombit shqiptar dhe lëvizjen nacionale shqiptare", *passim*, III (1953), f. 51-66; Dhimitër Shuteriqi, "Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe", *passim*, IV (1953), f. 3-55.

<sup>2</sup> Stefanaq Pollo, "Probleme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare", *Studime historike*, I (1965), f. 123-132.

<sup>3</sup> Stavri Naçi, "Disa vërejtje rreth shtruarjes teorike të problemit të Lëvizjes Kombëtare", *Studime historike*, II (1965), f. 123-145.

<sup>4</sup> Injac Zamputi, "Shënime mbi disa aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk", *Studime historike*, I (1965), f. 123-132; idem, "Elementë të vetëdijes shqiptare në përpjekjet për liri, për gjuhën shqipe e për arsim në shek. XVI-XVII", *Studime historike*, III (1965), f. 37-59.

Frashëri,<sup>5</sup> të cilët në atë klimë të vështirë presioni ideologjik shtruan edhe çështjen e studimit empirik të problemit më shumë se të atij teoriko-ideologjik, është fakt se konformizimi i fenomenit të nacionalizmit me skemat e teorisë marksiste-leniniste<sup>6</sup> dominuan studimet dhe debatet shkencore për këtë temë.

Përsa i përket fillesave të nacionalizmit shqiptar ishin këto diskutime që, gjysmën e dytë të shek. XIX si periudhë, dhe Lidhjen e Prizrenit si ngjarje, i evidentuan respektivisht si kohën dhe si formën e parë të shprehur të nacionalizmit shqiptar.<sup>7</sup> Në fund të këtyre studimeve dhe debateve u konkludua në mendimin që, rrënjët e Rilindjes Kombëtare duhen kërkuar në kryengritjet popullore anti-osmane, të cilat u zhvilluan si kundërpërgjigje ndaj Reformave të Tanzimatit (1839),<sup>8</sup> kurse “zgjimi” politik i shqiptarëve u krye vetëm kur Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit vendosën shkëputjen e disa territoreve shqiptare nga trangu amë;<sup>9</sup> kurse kulturalisht, si hapi përgatitor drejt zgjimit politik, me aktivitetin kulturor të Naum Veqilharxhit në vitet 30-40 të shek. XIX.<sup>10</sup> Kjo paradigmë e formëzuar qysh në mes viteve '60 është transplantuar edhe në versionin më të ri të *Historisë së Popullit Shqiptar* (2002).<sup>11</sup>

Studimi monografik mbi *Zgjimin Kombëtar të Shqiptarëve* i Stavro Skëndit (1967),<sup>12</sup> nuk shënoi ndonjë risi në këtë aspekt, pasi veçse

<sup>5</sup> Kristo Frashëri, “Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, *Studime historike*, III (1965), f. 103-132.

<sup>6</sup> Për një model trajtimi tërësisht skematik të çështjes së nacionalizmit shqiptar sipas teorisë marksiste-leniniste, shih: Ligor Mile, “Mbi Lëvizjen Nacional-çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk”, *Studime historike*, I (1965), f. 61-113. Për një version më të zgjeruar të këtij trajtimi sipas skemave teorike marksiste shih veçanërisht “Hyrjen” e Ligor Mile, *Kryengritjet popullore në fillim të Rilindjes sonë (1830-1877)*, Universiteti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë e Gjuhësisë, Tiranë: 1962; Petrika Thëngjilli, *Kryengritjet popullore kundërosmane në Shqipëri, 1833-1839*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë: 1981.

<sup>7</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Universiteti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë: 1965.

<sup>8</sup> Ibid., f. 7-8.

<sup>9</sup> Ibid., f. 9, 113-201.

<sup>10</sup> Ibid., f. 49-55.

<sup>11</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë: “TOENA”, 2002, f. 678-680; *Po aty*, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX - 1912).

<sup>12</sup> *The Albanian National Awakening, 1878-1912*, Princeton University Press, 1977.

përforcoi atë realitet historiografik që tashmë ishte formëzuar brenda kufijve të shtetit shqiptar, pra që nacionalizmi shqiptar si veprim politik u shfaq me krijimin e Lidhjes së Prizrenit. Një vlerësim i tillë mbi fillesat e nacionalizmit shqiptar shërbeu veçse për të vulosur edhe jashtë shtetit shqiptar paradigmën shkencore që sapo kishte marrë formë brenda tij.

Kontributi që solli studimi i S. Skëndit, krahasuar me studimet brenda kufijve të shtetit shqiptar, konsistonte në gamën më të gjerë të dokumentacionit perëndimor që autori kishte shfrytëzuar; por, ajo që në këtë aspekt i bashkonte punimet, kryer si brenda shtetit shqiptar, ashtu edhe në Perëndim, ishte fakti se të dyja palët nuk kanë përdorur aspak dokumentat që ruhen në arkivat osmane.

Në vëmendjen shkencore shqiptare ka kaluar pa lënë gjurmë një studim i publicistit Tajar Zavalani i titulluar *Nacionalizmi shqiptar* (1969).<sup>13</sup> Është interesant fakti që Zavalani është i pari që tregon se rrënjët e nacionalizmit shqiptar duhen kërkuar në periudhën e pashallëqeve, por ky vlerësim i tij nuk vjen si fryt i parashtrimit prej autorit të fakteve të reja historike, apo si pasojë e ndonjë analize logjike dhe të qëndrueshme të tij. Qasja në këtë mënyrë ndaj këtij problemi, më së shumti, rezulton të jetë një gjykim intuitiv i autorit, apo një dëshirë e paargumentuar që fillesat e nacionalizmit shqiptar t'i shtyjë sa më thellë në kohë.

Një risi, një hap përpara në këtë drejtim shënon referati i Aleks Budës: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike”, mbajtur në *Konferencën Kombëtare të Studimeve për Lidhjen e Prizrenit* (1978).<sup>14</sup> Ndonëse nuk largohet nga paradigma tashmë e formëzuar për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe fillesat e saj,<sup>15</sup> përsa i përket rrënjëve të nacionalizmit shqiptar autori ofron një qasje sa marksiste, aq edhe një që në vetvete mbart disa elementë që duhen analizuar. Sipas Budës,

“Tregjet ndërkrahinore [respektivisht të pashallëqeve të Shkodrës dhe Janinës], të formuara gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII, qenë një hap drejt unitetit ekonomik të vendit e u shërbyen këtyre formacioneve shtetërore feudale shqiptare si bazë për të bashkuar shumicën dërrmuese të popullsisë shqiptare në kuadrin e dy formacioneve politike paralele. ....

<sup>13</sup> “Albanian Nationalism”, *Nationalism in Eastern Europe*, University of Washington Press, Seattle & London: 1969, f. 55-92.

<sup>14</sup> Aleks Buda, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike”, mbajtur në *Konferencën Kombëtare të Studimeve për Lidhjen e Prizrenit* (1978), vëll. I, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë: 1979, f. 10-29.

<sup>15</sup> Ibid., f. 13-14.

[Këtu është fjala] për një proces me elementë ekonomikë dhe politikë pozitive që çonin përpara zhvillimin e për më tepër ishin shprehje e një qëndrese të përgjithshme të një kombësie të nënshtruar në të cilën bënte pjesë edhe klasa e fuqizuar shqiptare. Ky ishte një proces, i cili, siç thekson Engelsi për Mesjetën, favorizonte formimin e kombeve e të shteteve kombëtare në bazë terrioresh unitare nga pikëpamja e kombësisë e të gjuhës”.<sup>16</sup>

Buda është i pari studiues shqiptar që duke operuar me teorinë marksiste shtratin e nacionalizmit shqiptar e kërkon tek pashallëqet, qysh në fund të shek. XVIII. Hapësirat ekonomike kompakte që u krijuan respektivisht me qendër Shkodrën në Veri dhe Janinën në jug, teorikisht ai i konsideron si realitete pararendëse të cilat përgatitën ngritjen në shkallë më të lartë të vetëdijes dhe të procesit unifikues kombëtar shqiptar. Ndonëse kjo tezë mbështetet tërësisht në teorinë marksiste, dhe jo në dokumenta të kohës, interesant është fakti që Buda evidenton ekzistencën e “klasës së fuqizuar shqiptare”.<sup>17</sup> Në fakt, në vitin 1808 ishte kjo kastë e fuqishme ballkanike, në të cilën bënte pjesë edhe ajo shqiptare, e cila e mbledhur në Stamboll, nëpërmjet dokumentit të njohur me emrin *Sened-i Ittifak* (Dokumenti i Aleancës) edhe juridikisht legalizoi autoritetin tejet të dobësuar të sulltanit në provincë dhe njohu pozitën tashmë të fuqishme të parive provinciale ballkanike.<sup>18</sup>

Brenda kornizave të qarta dhe politikisht të pasfidueshme marksiste, Buda nxjerr në pah determinimin e faktorit ekonomik mbi të tjerët, por në këtë rast skema teorike gjen përafrim me realitetin historik.\* Ndërsa pozita dhe fuqia ekonomike luajtën një rol përcaktues në misionin që paria shqiptare i kishte përcaktuar vetes, Buda, si pasojë edhe e skemës teorike marksiste që ka aplikuar, ka shpërfilluar tërësisht dimensionin e jashtëm të zhvillimeve në viset shqiptare gjatë dekadave të para të shek. XIX; për pasojë, çdo zhvillim shqiptar është klasifikuar tërësisht si fryt i zhvillimeve të brendshme<sup>19</sup> dhe aspak pjesë e një

<sup>16</sup> Ibid., f. 17-18.

<sup>17</sup> Ibid., f. 18.

<sup>18</sup> Halil İnalçık, “Sened-i İttifak ve Gülhane Hatt-ı Hümayunu”, *Osmanlı İmparatorluğu: Toplum ve Ekonomi*, Eren, İstanbul: 1993, f. 343-344.

\* Shih më poshtë letrën e Ismail bej Vlorës nga Arkivi osman i Kryeministrisë (Stamboll).

<sup>19</sup> A. Buda, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...”, f. 18-20.

realiteti që kishte filluar të ndryshonte në Ballkan me kryengritjet greke dhe serbe për pavarësi.

Në studimet e tyre, kohësisht më të fundit për këtë problem, studiueset Nuray Bozbora<sup>20</sup> dhe Nathalie Clayer<sup>21</sup> fillesat e nacionalizmit shqiptar i kanë vendosur kryesisht në gjysmën e dytë të shek. XIX, pra gjysëm shekulli pas fqinjëve grekë dhe atyre sllavë, dhe më së shumti gjeneza e këtij fenomeni është kërkuar në zhvillimet ndërkombëtare të vitit 1878.

Në përfundim të këtij vështrimi të shkurtër kritik mbi punimet kryesore të kryera deri më sot mbi fenomenin e nacionalizmit shqiptar, mund të themi përmbledhtazi se, tre janë opinionet e ngulitura deri më sot në lidhje me fillesat e nacionalizmit shqiptar:

së pari, shprehja e parë e nacionalizmit shqiptar ishte Lidhja e Prizrenit;

së dyti, zgjimi kulturor i shqiptarëve ka filluar me Naum Veqilharxhin në vitet 30-40 të shek. XIX, dhe,

së treti, mendimi nationalist shqiptar i ka fillesat jashtë vendit, në klubet e emigracionit shqiptar, në gjysmën e dytë të shek. XIX.

Në ravijëzimin e kësaj paradigme, me sa duket, ka ndikuar dukshëm edhe fakti se në shumicën e tyre dërrmuese autorët, si shqiptarë ashtu dhe të huaj, duke mos qenë studiues osmanistë nuk kanë përdorur dokumentacionin dhe literaturën që ruhet në arkivat dhe bibliotekat osmane, ndërkohë që ndryshe qëndron puna me studiuesit osmanistë. Studiuesja turke, N. Bozbora krahas dokumentacionit britanik, ka përdorur edhe dokumentacionin osman, por më i hershmi dokument osman i përdorur prej saj kohësisht i takon ngjarjeve të Lidhjes së Prizrenit. Ky rast është një model klasik i atij kur struktura teorike e ndërtimit të punimit ka orientuar edhe kërkimin në dokumentacionin arkivor.<sup>22</sup>

Kurse Nathalie Clayer që në hyrje të studimit të saj bën me dije kategoritë e dokumentacionit osman që ka përdorur: vjetarët statistikorë

---

<sup>20</sup> Nuray Bozbora, *Osmanlı Yönetiminde Arnavutluk ve Arnavut Ulusçuluğu'nun Gelişimi*, Boyut Yayınları, İstanbul 1997.

<sup>21</sup> *Aux origines du nationalisme albanais: la naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*, Karthala, Paris: 2007. Për versionin shqip të këtij libri shih, Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslymane në Evropë*, Tiranë: "Përprojekta", 2009.

<sup>22</sup> N. Bozbora, *Osmanlı Yönetiminde Arnavutluk* ....., f. 293-294.

dhe jetëshkrimet e personaliteteve shqiptare që kanë shërbyer në administratën e Shtetit Osman,<sup>23</sup> të cilat kohësisht i takojnë gjithashtu gjysmës së dytë të shek. XIX. Mosthellimi në arkivat osmane të dyja studiueset e lartpërmendura i ka privuar nga njohja e problemit të nacionalizmit shqiptar thellë në kohë kur sistemit të pashallëqeve po i vinte fundi dhe, me kryengritjet greke dhe serbe për pavarësi, në horizont po shfaqeshin ndryshime të pakthyeshme në gjeopolitikën e Ballkanit.<sup>24</sup>

Sidoqoftë, duke parashtruar në mënyrë sintetike këto tre opinione tashmë të ngulitura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, mendoj se tendenca për t'i afruar në kohë fillesat e nacionalizmit shqiptar është metodologjikisht e gabuar, pasi zhvillimet politike ndërkombëtare që çuan në krijimin e Lidhjes së Prizrenit është fakt se nxorrën në pah jo një nivel të avancuar të mendimit, por të veprimit politik të nacionalizmit shqiptar.

Në fakt, gjeneza e lëvizjes nacionale të një populli shënohet atëherë kur një individ apo një grup individësh shpallin se ai komb ekziston dhe ai apo ata individë, pjesë e atij kombi, marrin përsipër ta provojnë një realitet të tillë.<sup>25</sup> Pra, gjeneza e lëvizjes nacionale të një populli shfaqet kur lind mendimi politik për të jetuar më vete, kur lind ideja e mëvetësisë kombëtare.

Por, ndërsa është i rëndësishëm identifikimi i fillesave, metodologjikisht do të ishte më e saktë dhe korrekte të identifikohen edhe elementët formëzues të vetëdijes nacionale shqiptare, që në fakt përgatitën edhe mjedisin për lindjen e Lëvizjes Nacionale Shqiptare. Një gjë e tillë kërkon depërtimin thellë në kohë dhe pashmangshmërisht edhe trajtimin në këtë këndvështrim të dokumentave të hershme të shqipes të shkruara me të gjitha alfabetet: latin, arab e grek. Metodologjikisht, kjo na bën të mendojmë se format më të hershme të tij duhet t'i kërkojmë edhe më herët. Dhe për këtë krahas burimeve dokumentare me bazë vendase dhe atyre me origjinë nga kancelaritë perëndimore, duhet të

<sup>23</sup> N. Clayer, *vep. e përm.*, f. 17.

<sup>24</sup> H. Erdem, "Perfidious Albanians' and 'zealous governors': Ottomans, Albanians, and Turks in the Greek War of Independence", *Ottoman Rule and the Balkans, 1760-1850: Conflict, Transformation, Adaptation*, Proceedings of an International Conference held in Rethymno, Greece, 13-14 December 2003, eds. A. Anastasopoulos & E. Kolovos, University of Crete, Rethymno: 2007, f. 213-40.

<sup>25</sup> A. Thiese, *Krijimi i identiteteve kombëtare: Evropa e shekujve XVIII – XX*, Dukagjini 2004, f. 9-10.

kërkojmë edhe në arkivat e Perandorisë Osmane, pjesë e së cilës ishin edhe shqiptarët, por tashmë me shumicë popullsie të islamizuar.

Deri më sot në asnjë rast nuk është shtruar pyetja se çfarë ka menduar elita shqiptare përkundrejt zhvillimeve të tilla që po ndryshonin konfigurimin politik të rajonit në dekadat e para të shek. XIX. Në se statusquo-ja politike ndryshon si rezultat i një konstelacioni të ri politik, është krejt e natyrshme që elementët e çdo grupi të caktuar etnik brenda një formacioni shtetëror multietnik të tentojnë të vënë në pah ato elementë që ata i bashkojnë, madje të shkojnë edhe më tej duke insistuar për të ekspozuar veten si një grup me veçori të spikatura, të ndryshme nga të tjera, për më tepër nga fqinjët, duke e bërë atë të jetë *sui generis*. Është logjike të mendosh që vetëm kështu çdo grup etnik mund të luftojë për të siguruar mbijetesën, madje në kushte optimale të aspirojë edhe për sundim mbi fqinjët. Në rastin shqiptar, kur i gjithë Ballkani i krishterë ishte zgjuar dhe kishte shtruar jo vetëm diplomatikisht por edhe me armë zgjidhjen e çështjes së tyre kombëtare, krahasuar me fqinjët duhet thënë se kemi një specifikë që ka të bëjë me faktin që shumica e shqiptarëve në fund të shek. XVIII – fillim i shek. XIX ishin myslimanë, madje fuqia politike, ushtarake dhe ekonomike e viseve shqiptare ishte në duart e elementit elitar mysliman.

Në vitet '20 të shek. XIX, rajoni i Epirit, pas asgjësimit të Ali Pashës, njohu zhvillime të rëndësishme. Kjo dëshmohet më së miri nga letërkëmbimi që gjendet në arkivat osmane, letërkëmbim i cili përfshinte autoritetet osmane, elitën myslimane shqiptare dhe drejtuesit e kryengritjes greke. Studiuesi turk Hakan Erdem është i pari që filloi të eksplorojë natyrën e marrëdhënieve tripalëshe osmano-shqiptaro-greke në kontekstin e zhvillimeve gjatë viteve të Revolucionit Grek (1821-1830).<sup>26</sup> Përtej marrëdhënieve midis qendrës dhe një province osmane, ky dokumentacion reflekton edhe marrëdhëniet mes një shteti mysliman dhe shqiptarëve, një prej komuniteteve etnike përbërëse të këtij shteti, por me shumicë dominuese gjithashtu myslimane. Ky dokumentacion zbulon se përfaqësuesit më të spikatur të elitës shqiptare janë realisht të avancuar në mendimin e tyre politik për kohën.

Në një letër të datës 29 nëntor 1828, drejtuar pjesëtarëve të elitës shqiptare të kohës, Ismail bej Vlora (gjyshi i Ismail Qemalit) i drejtohet disa krerëve shqiptarë të Shqipërisë së Jugut dhe u propozon atyre që të

<sup>26</sup> H. Erdem, *art. i cit.*, f. 213-240.

mos merren me shtypjen e Kryengritjes Greke, siç ishin urdhëruar nga Porta e Lartë, por u kërkon që të takohen në qytetin e Beratit “për të diskutuar për avenirin e Shqipërisë, me kushtin që [atje të bisedojmë] si bij të lirë” të Shqipërisë.

Në vijim po paraqisim përkthimin e plotë shqip të kësaj letre, \* që Ismail bej Vlora e ka shkruar në greqisht, por që shoqërohet edhe nga përkthimi integral në gjuhën osmane:

Ky është përkthimi në osmanisht i letrës së Ismail bej Vlorës dërguar Hasan agës dhe Abdyl agës, shkruar në datën 29 të muajit Teşrin-i Sani / 29 nëntor 1828:

Pas komunikimit të rangut tuaj [social/ekonomik/politik],

po ju bëj me dije se, ngaqë guvernatori i Rumelisë është vënë së tepërmi në pozitë të vështirë me fillimin e sulmeve nga të gjitha anët prej komitëve grekë, shqiptarët kanë ardhur nga çdo anë dhe janë grumbulluar në Janinë, dhe prej këndeje, nën drejtimin e Sulejman bej Konicës, Tahir aga Abazit, Veli aga Grebenesë dhe agallarëve të tjerë, janë urdhëruar të veprojnë mbi komitetet e lartpërmendur. Meqënëse qëllimet dhe veprimet e guvernatorit të lartpërmendur ndaj Shqipërinë janë të mbrapshta, për ta vënë atë në gjumë [le të shkojmë në Janinë], dhe për të qarë hallet e Shqipërisë, ashtu siç do mblidhemi, të shkojmë në Belgradin shqiptar \*\* për të projektuar dhe miratuar [qëndrimin që duhet mbajtur për] të ardhmen e Shqipërisë. Vetëm se [në Berat duhet shkruar] me një kusht që, të gjithë ne [të paraqitemi si ] bij të lirë [të Shqipërisë] dhe të çliruar nga çdo lloj varësie.

Guvernatori i Rumelisë neve të mos nga çojë në Virlestene (Velestino ?), ndërkohë që, qëllimi i tij është të na përdorë sikur të ishim në situatë mobilizimi të përgjithshëm [ushtarak] të Rumelisë, dhe të na mësojë [se si duhet të reagojmë; këtë e bën] ngase ju jeni nga paria e vendit dhe njerëz që u shkon fjala në Shqipëri.

Mos u nxitoni për t'i shkatërruar dhe asgjësuar komitetet [grekë], pasi sikurse e dimë të gjithë, ajo që po ndodh me punët e grekëve do të na ndodhë edhe neve. Që punët e popullit shqiptar të rregullohen ashtu siç duhet dhe të merren nën kontroll të plotë, jam marrë vesh dhe kam rënë në një fjalë me Silahdar [Zylyftar] Podën, me anë të një gruaje që është kushërirë e jona. Ngaqë edhe ju jeni pjesë e parisë së Shqipërisë, hapini mirë sytë për të mbrojtur atdheun tonë. Kështu që, kur punët e Shqipërisë

\* Ky dokument gjendet në Arkivin e Kryeministrit në Stamboll: BOA, Hatt-ı Hümayun 21436 –B. Faksimilja e përkthimit të plotë osmanisht të këtij dokumenti do ta gjeni në fund të artikullit.

\*\* Termi osmanisht i përdorur për të identifikuar qytetin e Beratit.

të rregullohen dhe të merren nën garanci dhe kur t'i kemi zgjidhur të gjitha problemet tona, me ndihmën e Zotit të Madh i rregullojmë ne punët e grekëve.

Po ju shkruaj që jam në pritje të përgjigjes suaj për këtë problem.

Siç edhe kuptohet nga brendia e letrës, shkak për hartimin e saj është bërë urdhri osman që trupat shqiptare nën drejtimin e komandantëve shqiptarë të shkojnë dhe të shtypin kryengritjen greke. Për këtë Ismail bej Vlora akuzon dhe bën përgjegjës valiun osman të Rumelisë. Në kontekstin e këtyre zhvillimeve ai u sugjeron disa krerëve shqiptarë të mblidhen në qytetin e Beratit<sup>27</sup> për të biseduar për të ardhmen e Shqipërisë, në kushtet kur Kryengritjes Greke për pavarësi po i vinte fundi me sukses, dhe osmanët nuk po arrinin ta frenonin dot suksesin e saj.

Pjekuria politike e Ismail bej Vlorës shpaloset qartë kur vëren se guvernatori osman i Rumelisë kërkonte t'i përdorte shqiptarët thjesht si trupa ushtarake që vepronin qorrazi në emër të shtetit osman për shtypjen e kryengritjes greke. Në këto kushte ai u sugjeron homologëve të tij shqiptarë që të shmangnin pjesëmarrjen e tyre në këtë veprim, pasi në se edhe shqiptarët do të kërkonin shkëputje nga Perandoria Osmane, qëndrimi osman do të ishte i njëjtë me atë që po shpalosej në atë moment ndaj "rebelëve" grekë.

Këtë letër Ismail bej Vlora ua drejton disa *bejlerëve* dhe *agallarëve* të viseve të Shqipërisë Jugore. Titujt osmanë *bej* dhe *aga*, që u atribuohen atyre, aq sa shprehin pozitën e tyre të fortë ekonomike, po aq sqarojnë edhe statusin e tyre politik, çka në masë determinante përcakton edhe natyrën e marrëdhënieve të tyre me shtetin osman dhe me popullsinë vendase shqiptare. Këta krerë në sytë e Shtetit Osman ishin udhëheqës lokalë të njohur zyrtarisht prej tij, një realitet ky që dëshmohej edhe nga fakti se ata thirreshin nga Shteti Osman në fushata të planifikuara ushtarake. Nga ana tjetër, ata ishin edhe drejtuesit legjitimë të popullsisë lokale, pozitë kjo e fituar si rezultat i një procesi të gjatë emancipimi social e politik përgjatë shekujve të mëparshëm osmanë.

Kjo pozitë qartësisht e përcaktuar ekonomike, politike dhe sociale e bënte këtë kastë të fuqishme ekonomike dhe politike të ishte shumë e ndjeshme ndaj çdo zhvillimi që do të sillte ndryshime në ekuilibrat gjeopolitikë në rajon, madje çdo ndryshim i kësaj situatë natyrshëm që ata do t'i bënte jo vetëm faktorë, por edhe protagonistë të saj. Me këtë

<sup>27</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, f. 678-680.

shpjegohet fakti se pse i ndiqnin nga afër zhvillimet që po ndodhnin edhe në brendësi të territoreve greke.

Ismail bej Vlora, me shkallën e njohjes së dokumentacionit që kemi deri më sot, është i pari pjesëtar i elitës shqiptare të kohës, i cili realitetin e ri politik që po krijohej në brendësi të Greqisë së sotme e pa përtej kufijve të çifligjeve të tij.<sup>28</sup> Është krejt e natyrshme që pjesëtarë të elitës shqiptare duke qenë edhe autoritete provinciale osmane e kishin shumë të lehtë që autoritetin politik që i kishte dhënë Stambolli ta përdornin për interesa përtej atyre personale, dhe më konkretisht siç thotë Ismail beu “për punët e Shqipërisë” apo “për punët e popullit shqiptar”.<sup>29</sup> Këtu është vendi të perceptojmë dhe të vlerësojmë drejt shkallën e emancipimit politik të elitës shqiptare: ky emancipim është i një natyre të veçantë për shkakun se ndonëse elita shqiptare ndante të njëjtin besim fetar me shtetin osman, ky dokument dëshmon se përfaqësues të saj kanë arritur tashmë pjekurinë e duhur politike të të menduarit për shkëputje nga Perandoria Osmane. Madje, edhe termi *vatan* i përdorur nga Ismail bej Vlora, nga një term tradicionalisht i përdorur në gjuhën politike të Islamit në kuptimin *atdhe i myslymanëve* (homeland of muslims), në këtë dokument përdoret me kuptimin *atdhe kombëtar* (patria).<sup>30</sup> Ky dokument ndoshta është nga të parët në gjuhën politike osmane kur ky term pëson një ndryshim të tillë semantik.<sup>31</sup>

Për të shkuar më tej, në ligjërimin e Ismail bej Vlorës kur bëhet fjalë për konceptin e vendit të shqiptarëve në të gjitha rastet përdor termin *Shqipëri* (Arnabutluk), madje shoqëruar në masë dërrmuese me togfjalëshin *punët e Shqipërisë* (Arnabutluk maslahatı).

Falë integritit në strukturat shtetërore dhe ushtarake osmane, paria shqiptare tashmë e islamizuar gëzonte një pozitë të lakmueshme ekonomike dhe ushtarake. Është e rëndësishme të vihet në dukje se eliminimi i Ali Pashë Tepelenës dhe i Pashallëkut të Janinës në viset shqiptare nuk la pas vakuum autoriteti. Vendi nuk mbeti pa kokë. Këtë vakuum, siç bëhet e qartë edhe nga ky dokument, e mbushën Ismail bej Vlora, Zylyftar Poda, Sulejman bej Konica, Veli aga Grebeneja, Tahir

<sup>28</sup> H. Erdem, *art. i cit.*, f. 229.

<sup>29</sup> *Ibid.*, f. 231.

<sup>30</sup> B. Lewis, *Modern Türkiye'nin Doğuşu*, 7. Baskı, TTK Yayınları, Ankara 1998, f. 332-333; *Idem, The Political Language of Islam*, The University of Chicago Press 1988, f. 40-41.

<sup>31</sup> H. Erdem, *art. i cit.*, f. 236.

Abazi etj., të cilët u shndërruan jo vetëm në mediatorët e komunikimit zyrtar mes Stambollit dhe popullsisë shqiptare, por ata, përmes këtij dokumenti dëshmojnë se vetëm disa vjet pas agjësimit të Ali Pashës kishin avancuar dukshëm në mendimin e tyre politik nationalist.

Me këtë realitet dhe pozitë të fuqishme të elementit shqiptar në Ballkan duhet shpjeguar edhe fakti pse Ismail bej Vlora në fund të kësaj letre shprehet: “Kështu që, kur punët e Shqipërisë të rregullohen e të merren nën garanci, dhe kur t’i kemi zgjidhur të gjitha problemet tona, me ndihmën e Zotit të Madh, i rregullojmë ne punët e grekëve”.


Nga ana tjetër, ky dokument na bën me dije edhe faktin tjetër, që Pashallëku i Ali Pashës mes të tjerash ishte edhe një institucion i cili kishte vendosur urat e njohjes dhe komunikimit mes elitës shqiptare të kohës. Në këtë dokument citohen mbiemrat e shumë personaliteteve të kohës, të cilat më pas do të jenë mbiemrat e familjeve të mëdha shqiptare, pjesëtarë të së cilave morën përsipër përmbushjen e misionit kombëtar dhe ngritjen e shtetit shqiptar. Me fjalë të tjera, fenomeni i pashallëqeve në viset shqiptare duhet konsideruar jo vetëm si model ekstrem i procesit të decentralizimit të autoritetit shtetëror osman, por në rastin e Pashallëkut të Janinës edhe si një strukturë politike e mbarsur me fillimet e nacionalizmit shqiptar.

Lindja e mendimit politik nationalist të një kombi shënon një stad cilësor që, nga njëra anë i jep fund fazës së evidentimit të elementëve formëzues të lindjes së kombit, kurse nga ana tjetër i hap rrugë veprimit të organizuar politik drejt një lëvizjeje e cila çon në krijimin e shtetit kombëtar. Ky dokument është dëshmi e faktit që edhe shqiptarët ishin zgjuar dhe po mendonin për mëvetësinë e tyre, ashtu sikurse ishin duke bërë fqinjët e tyre grekë e sllavë.

Në këtë shkrim u përpoqëm të parashtrojmë dhe të analizojmë disa të dhëna të reja mbi fillesat e mendimit nationalist shqiptar, të cilat mendojmë se mund të shërbejnë si indikator për fillimin e një pune edhe më të thelluar në kërkimin e rrënjëve historike të nacionalizmit shqiptar, duke filluar qysh në kohën e Pashallëkut të Janinës dhe në lidhje të ngushtë me zhvillimet e reja gjeopolitike që po ndodhnin në Ballkanin osman: kryengritjes greke dhe serbe për pavarësi.<sup>32</sup>

---

<sup>32</sup> H. İnalçık, *art. i cit.*, f. 343-344.



Faksimile e riprodhuar sipas botimit të: H. Erdem, “ ‘Perfidious Albanians’ and ‘zealous governors’: Ottomans, Albanians, and Turks in the Greek War of Independence”, *Ottoman Rule and the Balkans, 1760-1850: Conflict, Transformation, Adaptation*, University of Crete, Rethymno 2007, Appendix III

*S u m m a r y*SOME NEW INFORMATION ON THE BEGINNINGS  
OF ALBANIAN NATIONALISM

One of the most complex subjects in Albania's modern history is the study of Albanian nationalism. Up to our days, deep academic treatment of the subject has not been possible and its roots still keep uncovered many elements. It seems that the two principal factors for these difficulties have been the historical fate of the Albanians during the 19<sup>th</sup> and the 20<sup>th</sup> century, as well as the transformation of nationalism into an ideology during the period of Communism.

The genesis of a nationalist movement of a nation is marked when a person or a group of people declare that this nation exists and these, one or more, people, part of this nation, undertake to find the proofs for such reality. That is to say, that the genesis of a nationalist movement appears when the political thought of living apart and the idea of national independence are born.

During the 1820s, after the annihilation of Ali Pasha, the region of Epirus met with important changing. This is perfectly testified by the correspondence that is found in the Turkish archives and involved Ottoman authorities, the Albanian Muslim elite and leaders of the Greek Revolution. Beyond the relations between the center and an ottoman province, this documentation reflects the rapports between a Muslim country and the Albanians, one of the ethnic communities constituting this country, however having a dominating Muslim majority. This documentation reveals that the most conspicuous representatives of the Albanian elite are, for the times, truly advanced in their nationalist thought.

The powerful economic and political position made the Albanian elite very sensitive towards any evolution that would bring transformations to the geopolitical balances of the region. Furthermore, every change on this situation would naturally turn them, not only into factors, but also into its protagonists. This is the reason why they would closely follow the evolutions that were taking place, even inside the Greek territories, during the first two decades of the 19<sup>th</sup> century.

